



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostorno Planiranje i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

DATE/A:	02.12.2022
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Albnor Mullabazi, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit - Komuna e Rahovecit
CC:	Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për pëlqim për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt “Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit 2022-2030”

I nderuar z. Mullabazi,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 11 (paragrafi 1.9, nën paragrafi 1.9.1) Komuna e Rahovecit ka dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 06.10.2022 me numër të protokollit 1557-2/22, kërkesën “për marrjen e pëlqimit për **hapjen e shqyrtimit publik** të Projekt “ Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit 2022-2030”.

Sipas neni (9 paragrafi 2 nën paragrafit 2.3), Ministria Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së Projekt “Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit 2022-2030” me “Planin Hapësinor të Kosovës –Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+” dhe me Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, Ministria nxjerr Vendim për pëlqim, që Kuvendi i Komunës së Rahovecit sipas procedurës për Përgjegjësitë e Autoritetit Komunal për Planifikimit dhe Menaxhim Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, **Mund të bëjë Hapjen e Shqyrtimit Publik.**

Me respekt,

